

TERMAT E REFERENCËS PËR ZHVILLIMIN E HULUMTIMIT TË NEVOJAVE TË TREGUT KOSOVAR PËR SHKATHTËSITË TË TIK NË SEKTORËT E TJERË (04/STIKK/2019)

1. Hyrje

Si një katalizator në industrinë dinamike të teknologjisë, STIKK përshpejton rritjen dhe progresin në ekonomi. STIKK ofron një platformë që bashkon liderët e teknologjisë për t'u lidhur dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe mbështet me entuziazëm anëtarët që shtyjnë përpara kufijtë e teknologjisë.

Që nga themelimi në 2008, STIKK arriti suksese të shumta dhe u bë një nga shtytësit kryesorë të industrisë së TIK-ut dhe komunitetit të TIK-ut në Kosovë. Gjatë përpjekjeve drejt zhvillimit të vazhdueshëm të industrisë së TIK, STIKK ka realizuar projekte të shumta që kanë për qëllim promovimin e sektorit të TIK të Kosovës, përmirësimin e kornizës ligjore, implementimin e hulumtimeve dhe analizave specifike të industrisë si dhe të ndihmojë në zhvillimin e profesional të aktorëve të sektorit.

Duke qenë se prezenca e teknologjisë është bërë pjesë përbërëse shumë e rëndësishme e sektoreve të biznesit, këtyre sektoreve i është rritur nevoja për inkuadrim të njerëzve të specializuar për menaxhimin e teknologjisë në stafet e tyre. Si pasojë, STIKK kërkon që të bëhet një hulumtim që do të identifikoj hapësirat mes shkathtësive të kërkuara në sektorët më të mëdhenj të tregut në Kosovë (p.sh. turizëm, energji e ripërtrishme, veshëmbathje, përpunim i drurit, etj.) dhe shkathtësive të ofruara nga institucionet arsimore dhe trajnuese në Kosovë, e që si rrjedhojë do të ndihmojë në përmbushjen e zbrazëtisë së aplikimit të veprimtarive të sektoreve përkatëse në teknologji të informacionit.

Identifikimi i zbrazëtisë në mes të kërkesës dhe ofertës në këtë treg specifik të punës, do të siguroj një kuptim gjithëpërfshirës të shkathtësive të TIK që nevojiten në Kosovë. Procesi i hulumtimit do të përfshijë hulumtimin në terren, analizën e të dhënave, përgatitjen e raportit si dhe finalizimin duke e printuar dhe promovuar këtë raport. Ky hulumtim do të shërbejë si një referencë gjatë takimeve B2B me sektorë të tjerë.

2. Qëllimet dhe rezultatet e pritura

Qëllimi i hulumtimit është që të tregoj se:

1. Çfarë aftësi kërkohen në tregun e punës së sektoreve të ndryshëm lokal nga fusha e TIK;
2. Çfarë aftësi do të nevojiten në fushën e TIK-ut në 3-5 vitet e ardhshme për të plotësuar kërkesën e sektorëve të tjerë;
3. Cili duhet të jetë fokusi i institucioneve të edukimit dhe trajnimeve në zhvillimin e aftësive në fushën e TIK-ut;
4. Cili është kualiteti i shërbimeve dhe produkteve të kompanive të sektorit TIK.

Hulumtimi duhet të përmbaj këto aktivitete:

1. Të shqyrtoj studimet ekzistuese, vlerësimet dhe raportet e përgatitura nga institucionet përkatëse qeveritare, OJQ-të, shoqata STIKK, agjencitë donatore dhe partnerët e tyre zbatues në lidhje me zhvillimin e shkathtësive të TIK në Kosovë;
2. Të bëj identifikimin, intervistimin dhe studimin e kompanive të sferave të ndryshme në aspektin e nevojës për aftësitë në TIK;

3. Të bëhet analiza e pritshmërive të kompanive nga sektorët e tjerë dhe nevojave të tyre nga sektori i TIK-ut;
4. Të analizoj të ardhmen në planprograme mësimore (shkolla dhe universitete) për profesionët të ndërlidhura me TIK-un, duke marrë parasysh planet lokale dhe rajonale në sektorin e TIK-ut;
5. Të bëj parashikimin tre-pesëvjeçar të profileve dhe aftësive të kërkuara në sektorin e TIK për aplikim në sektore tjera;
6. Të bëj analizën për aftësitë e kërkuara të TIK-ut që konsiderohen si aftësi të përshtatshme në sektorë të tjerë;
7. Të analizoj mundësitë dhe nevojat për aftësimin e punëtorëve me përshtatshmëri efektive;
8. Të mbaj një punëtori me palët e interesuara për konsultim mbi gjetjet; dhe
9. Të dorëzoj raportin përfundimtar mbi Analizën e Hendekut të Aftësive në sektorin e TIK në Kosovë.

Rezultatet që priten nga Kompanisë Konsulente janë:

1. Plani i punës, planifikimi kohor dhe një plan të sugjeruar (outline) të raportit;
2. Komunikim në bazë javore mes STIKK dhe Konsulenteve;
3. Dy pyetësor ose intervista (kualitative dhe kuantitative) të përgaditura;
4. Prezentimet e gjetjeve kryesore para STIKK-ut;
5. Raporti draft për STIKK-un dhe anëtarët për rishikim;
6. Përgatitja e raportit final në gjuhën shqipe dhe angleze;
7. Konsultime të mëtutjeshme rreth raportit final; dhe
8. Prezantim publik të te gjeturave (nëse kërkohet nga STIKK).

3. Pronësia intelektuale

Pas pagesës së detyrimeve financiare, STIKK dhe Ofruesi i Shërbimeve pajtohen që STIKK do të marrë pronësinë e hulumtimit në formën e tij të prekshme dhe të paprekshme (duke përfshirë kodin), si në kopjet e "hard" dhe "soft" dhe të drejtën për t'i përdorur ato si të përshtatshme.

4. Udhëzime për dorëzim të ofertave

Kompanitë e interesuara të dërgojnë ofertën teknike dhe financiare deri më **22 prill 2019** në info@stikk.org.

Hulumtimi duhet të punohet nga **1 maj** deri më **28 qershor 2019**. Vlera financiare e përgjithshme duhet të përfshijë edhe TVSH-në.

Inkuadroni çmimet për ditë për:

- Hulumtim në terren (15 ditë të planifikuara);
- Shërbimet analitike (10 ditë të planifikuara);
- Shërbimet e përgaditjes së raportit (5 ditë të planifikuara).

5. Kriteri i përzgjedhjes

STIKK do të përdor këto kritere të përzgjedhjes:

Kriteri	%
1. Kriteret Teknike	
1.1. Përvoja e punës	30
1.2. Metodologjia, plani i punës dhe plani kohor të planifikuar	40
1.2. Referenca me detaje të kontaktit (<i>minimum 3 referenca</i>)	10
2. Kriteret Financiare	
2.1. Çmimi më i favorshëm	30
Totali:	100

6. E drejta për ankesë

Çdo ofertues ka të drejt për ankesë, të cilën mund të dërgoni në info@stikk.org brenda 7 ditëve kalendarik nga momenti i pranimit të emailit me rezultate nga Zyra Ekzekutive e STIKK.

7. Raportimi

Konsulenti do t'i raportojë Menaxherit të Projektit të caktuar nga STIKK, i cili do të jetë përgjegjës për konsultimin me konsulentin në lidhje me hulumtimin. Gjatë periudhës së kontratës, STIKK do të pranojë një përditësim të rregullt të progresit të punës.

--

Për cdo pyetje, mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes email-it në këtë adresë: info@stikk.org. Kërkesat pranohen deri më **20 prill 2019**.